



Raport Vlerësues i Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (CAO)

**Ankesë në lidhje me Projektin e Bankers Petroleum (Projekt i Korporatës
Financiare Ndërkombëtare IFC #27306)**

Patos, Shqipëri

13 gusht 2013

*Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë/Ombudsman
Korporata Financiare Ndërkombëtare/
Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe*
www.cao-ombudsman.org

Rreth Këshilltarit të Përputhshmërisë

Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë “Ombudsman” (CAO), është mekanizmi i përgjegjës së pavarur për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencisë së Investimeve të Garantuara Shumëpalëshe (MIGA), degë të sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore. CAO, raporton direkt tek Presidenti i Grupit të Bankës Botërore dhe mandati i saj është të ndihmojë në adresimin e ankesave nga njerëzit e prekur nga projektet e përkrahura të IFC/MIGA, në një mënyrë që është e drejtë, objektive dhe konstruktive dhe që të përmirësojë rezultatet shoqërore dhe mjedisore të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion, shikoni www.cao-ombudsman.org.

Pasqyra e Lëndës

Pasqyra e Lëndës	3
Lista e Shkurtesave	4
1. Përmbledhje	5
2. Konteksti	5
2.1 Projekti	1
2.2 Ankuesi	5
3. Vlerësimi	6
3.1 Metodologjia	6
3.2 Përmbledhje e Intervistave të Vlerësimit	6
3.2.1 Perspektiva e Banorëve të Zharrëzës	6
3.2.2 Perspektiva e Kompanisë	7
3.2.3 Perspektiva e Sektorit Publik	7
3.2.4 Konteksti / Informacion Shtesë	9
4. Përmbledhje dhe Hapat e Mëtejshëm	10
4.1 Përmbledhje e Vlerësimit	10
4.2 Interesat e Përbashkëta	10
4.3 Hapat e Mëtejshëm	11
Shtojca A: Trajtimi i procesit të ankesës së CAO	12
Shtojca B: Intervistat e Vlerësimit të CAO	14

Lista e Shkurtesave

CAO	Këshilltari i Përputhshmërisë Ombudsman
IFC/KFN	Korporata Financiare Ndërkombëtare
MIGA/AIGSH	Agjencia e Investimeve të Garantuara Shumëpalëshe
AKBN/AKSHBN	Agjencia Kombëtare Shqiptare e Burimeve Natyrore
PIDs/DIP	Dokumentat e Informacionit të Projektit
EBRD/BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

1. Përmbledhje

Një ankesë u paraqit tek CAO në mars 2013, nga një ambientalist shqiptar (“Ankuesi”), në emër të banorëve të Zharrëzës, një komunitet ngjitur me fushën e naftës Patos-Marinëz. Ankuesi ngre shqetësime rreth teknikave të nxjerrjes së naftës nga Bankers Petroleum Albania Ltd., dhe pohon që disa incidente dhe aksidente të ndodhura, mund të jenë potencialisht të lidhura me këto teknika.

CAO konkludoi që ankesa përmbushte tri kriteret kryesore të saja dhe ndërmori një vlerësim të çështjeve dhe palëve të interesuara. Ky raport ofron një përmbledhje të projektit, ankesës, metodologjisë, rezultateve të vlerësimit, si dhe hapat e mëtejshëm.

2. Konteksti

2.1 Projekti¹

Sipas dokumentacionit të IFC-s, Bankers Petroleum operon dhe ka të drejta të plota që të rihvillojë fushënaftën e rëndë Patos-Marinëz, si aset in e saj kryesor, ndërsa gradualisht merr përsipër pushtet nga Kompania kombëtare shqiptare e naftës, Albpetrol. Në 2008, Bankers krijuan një plan strategjik për zhvillimin e Patos-Marinëz, duke pasur për qëllim rritjen e normave të gjetjes së naftës dhe përmirësimit të prodhimit, përmes aplikimit të metodave fillestare dhe më të zgjëruara të gjetjes së naftës.

Përveç Patos-Marinëz, Bankers ka të drejtë të rihvillojë edhe një fushënaftë të rëndë që gjendet afër Kuçovës dhe mban licencën për eksplorim për “Blokun F”, ngjitur me Patos-Marinëz. Strategjia e kompanisë është që të mbesin të përqëndruar në aktivitetet e eksplorimit dhe të prodhimit në Shqipëri.



Source: <http://ëëë.bankerspetroleum.com>

Në vitin 2009, IFC dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), secila ka ofruar nga një pako financimi, gjithpërfshirëse prej 50 milionë dollarë amerikanë, kredi të bazuar në rezerva për të ndihmuar financimin e planit zhvillimor të Patos-Marinëz dhe një kredi mjedisore prej 5 milionë dollarësh amerikanë dhe është e përkushtuar që të bëjë investim kapital prej 12 milionë dollarësh amerikanë CAD, për të ndihmuar zhvillimin e aseteve shqiptare të kompanisë. Në vitin 2013, IFC dhe BERZH, kanë shprehur përkushtim që të rrisin kredinë e bazuar në rezerva, secila me nga 50 milionë dollarë amerikanë..

2.2 Ankuesi

Në mars të vitit 2013, CAO mori një ankesë nga një ambientalist dhe ligjërues i Universitetit Shqiptar, me bazë në Tiranë, në emër të banorëve të komunës së Zharrëzës, një bashki afër fushës së naftës Patos-Marinëz, në jugperëndim të Shqipërisë. Ankesa ishte përkrahur nga një

¹IFC Faqja e të dhënave të projektit (PDS), Shqyrtim i Hershëm

inxhinier me bazë në Zharrëz, i cili është përfaqësuesi i banorëve të Zharrëzës. Ankuesi pohoi se teknikat e nxjerrjes së naftës të përdorura nga Bankers Petroleum, përfshijnë “nxitje” tërmetesh dhe lëkundje masive të tokës prej qindra hektarësh, që shkaktojnë plasaritje të shtëpive të banorëve dhe kërcënojnë të gjitha lagjet dhe fshatrat. Ankesa përfshinte, gjithashtu, deklarata në lidhje me një incident mbytjeje të një banori 60-vjeçar nga Marinëza, ndotje nga mbetjet e naftës të rrjeteve të ujitjes, dhe abortet në Zharrëz.

Ankesa e konteston zbatueshmërinë e udhëzimeve të Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë së IFC, në përgjithësi, dhe në veçanti atë të Standarteve të saj të Zhvillimit të Naftës në Tokë dhe të Gazit. Ankesa kërkon që CAO, të ndërmarrë një vlerësim të pavarur, të sigurojë shërbime ndërmjetësimi, dhe që të ndërmarrë një auditim përputhshmërie.

3. Vlerësimi

3.1 Metodologjia

Qëllimi i vlerësimit të CAO, është të sqarojë çështjet dhe shqetësimet e ngritura nga ankuesit, të kuptojë se si palët e tjera të interesuara, e shikojnë situatën, dhe të ndihmojë ankuesit dhe kompanitë të zgjedhin alternativat, më të mira për të zgjidhur ankesën nëpërmjet një nga dy funksionet e CAO: një zgjidhje të përbashkët / zgjidhje e ndërmjetësuar, ose një hetim përputhshmërie të dilijences ligjore të IFC, në projekt. Gjatë vlerësimit, CAO, nuk mbledh informacion të bëjë një gjykim mbi meritat e ankesës. (Shiko Shtojca A për një përshkrim të plotë të procesit të trajtimit të ankesës së CAO).

Vlerësimi i ankesës në lidhje me Bankers Petroleum, konsistonte në:

1. Një shqyrtim të gjithë dokumentave përkatëse të projektit;
2. Takime me ekipin e projektit të IFC;
3. Takimet konfidenciale (në besueshmëri të plotë), dypalëshe me ankuesin dhe përfaqësuesit e kompanisë dhe
4. Një vizitë të vendit të projektit, nga 18 deri më 23 maj, 2013.

Gjatë vizitës në vend, u organizuan intervistat me anëtarët e komunitetit dhe palëve të interesuara të sektorit publik dhe personi me bazë në Tiranë, i cili paraqiti ankesën, mori pjesë. Ekipi i CAO, u takua në mënyrë të pavarur me Bankers Petroleum.

Shiko Shtojca B, për një listë të të gjitha palëve të interesuara të intervistuar gjatë vizitës në vend, në Shqipëri.

3.2 Përmbledhje e Intervistave të Vlerësimit

3.2.1 Perspektiva e Banorëve të Zharrëzës

Banorët e Zharrëzës, të cilët ishin pyetur nga ankuesi me bazë në Tiranë dhe përfaqësuesi me bazë në Zharrëz, që të takohen me ekipin e vlerësimit të CAO, besojnë se teknikat e nxjerrjes së naftës së Bankers Petroleum, janë përgjegjëse për tërmetet e vazhdueshme në fshatin e tyre. Ata besojnë se këto tërmete, kanë rezultuar në dëmtim strukturor të shtëpive të tyre dhe të një ndjenje të përhershme frike dhe ankthi. Këta banorë, përfshinin katër pronarë shtëpiash,

shtëpitë e të cilëve CAO, i vizitoi, ku plasaritjet e konsiderueshme dhe dëmet strukturor, ishin të dukshme, dhe rreth 15 banorë të tjerë, të cilët morën pjesë në një takim të komunitetit të thirrur nga ankuesit që ngriti të njëjtat shqetësime. Banorët, të cilët folën me CAO, thanë që ata nuk iu besojnë thënieve të Bankers Petroleum se tërmetet janë fenomene natyrore e jo të shkaktuara nga kompania, sepse modeli dhe sjellja e lëkundjeve, është ndryshe nga aktiviteti sizmik "tipik". Fshatarët besojnë se gjatë këtyre tërmeteve të nxitura nga kompania, toka leviz "lart dhe poshtë", ndryshe nga "një anë në tjetrën" dhe shpërthimeve të zhurmshme e të panatyrshme, që në mënyrë tipike, duket se iu paraprijnë tërmetet.

Këta banorë të Zharrëzës, thanë se ata gjithashtu, kanë ngritur shqetësimet e tyre me qeveritarët lokalë dhe rajonal, por qeveria ka dështuar të sigurojë një gjykim adekuat ose zgjidhje.

3.2.2 Perspektiva e Kompanisë

Stafi i Bankers Petroleum, që u takua me CAO, përshkroi një seri të hapave të inicuar të kompanisë, të ndërmarrur që nga mesi i vitit 2009, që të kuptojë më mirë, të dokumentojë dhe komunikojë aktivitetin sizmik tek vendi i projektit. Këta hapa, përfshijnë punësimin me orë të plota të një gjeofizikanti dhe ndërmarrjen e analizave të thella të aktiviteteve të tyre, bashkëpunimin me Institutin Kombëtar Sizmologjik dhe Institutin Kombëtar të Gjeoshkencës, si dhe prodhimin e raporteve të ndryshme të analizës së të dhënave. Bazuar në këto dhe përpjekje të tjera, dhe mbi interpretimin e tyre të informacionit shkencor, ata besojnë se tërmetet e zonës, ndodhin në mënyrë natyrale dhe nuk janë shkaktuar nga metodat e nxjerrjes së naftës së kompanisë.

Kompania thotë se ata kanë bërë shume përpjekje të angazhojnë banorët e Zharrëzës, në dialog dhe ndarjen e informacionit rreth shkencës dhe shkaqeve të tërmeteve, por kjo përpjekje ishte e pashpresë, nga mosbesimi i vazhdueshëm dhe mungesa e vullnetit të banorëve, të angazhohen në mënyrë konstruktive ose të pranojnë gjetjet teknike.

Kompania, në kohët e fundit, ndërmori një "Projekt Sizmograf Instalimi", me qëllim që të mbështes rrjetin monitorues kombëtar dhe atë rajonal sizmik. Kompania thotë se do të përdorë të dhënat nga keta sizmografë, në mënyrë që të kuptojë më mirë dhe të komunikojë informacionin mbi tërmetet në zonën e saj të veprimit. Kompania gjithashtu do të bëjë blerjen e një „state of-the-art analysis software“/ një softueri për të analizuar "nivele e njohurive dhe të zhvillimit të të arrijturave shkencore“, në këtë fushë dhe atë do t'ia dhurojë Institutit Sizmik të qeverisë, për t'iu mundësuar që ata të bëjnë analiza dhe raportim më të mirë mbi ngjarjet sizmike në të gjithë vendin.

3.2.3 Perspektiva e Sektorit Publik

Palët e interesuara qeveritare lokale dhe kombëtare, kanë perspektiva të ndryshme mbi shkaqet e tërmeteve.

- Një përfaqësues i qeverisë lokale, që foli me ekipin e CAO, me kushtin e anonimitetit, tha se ai e studioi dhe punoi nga afër mbi çështjet e lidhura me tërmetet dhe e vuri në pyetje përputhshmërinë e kompanisë me rregullat e nxjerrjes së naftës. Ai mbështeti deklaratat që Bankers, është përgjegjëse për lëkundjet në zonën e projektit, por, gjithashtu, tha se beson që një shkencë më përkufizuese, mund t'i përgjigjet pyetjes përfundimisht.

- Kryetari i Bashkisë së Zharrëzës, tha se administrata e tij, nuk ka marrë pozicion zyrtar mbi shkakun e terrmeteve. Në pikëpamjet e tij, më shumë informacion, është i nevojshëm që të përcaktohet nëse terrmetet ndodhin në mënyrë të natyrshme, ose janë nxitur apo janë përkeqësuar nga metodat e shpimit të Bankers ose që të dyja. Ai shprehu zhgënjim që çështja nuk është zgjidhur akoma për aq shumë kohë, që vazhdon të përçajë qytetarët, shkakton protesta dhe shkakton mosbesim brenda banorëve dhe, pavarësisht studimeve të bollshme, e informacionet mbi terrmetet, administrata e tij, nuk ka qenë në gjendje të ndihmojë banorët dhe kompaninë, në mënyrë që të arrijnë në një konsensus ose të zgjidhin situatën ndryshe.
- Një përfaqësues i nivelit kombëtar të Agjencisë së Burimeve Natyrore (AKBN), tha se ekziston një mungesë kuptimi në Zharrëz dhe komunitetet e tjera, rreth aktivitetit të lartë sizmik të Shqipërisë, që njerëzit shpesh dështojnë të kontrollojnë kushtet sizmike të zonës, përpara se ata të ndërtojnë ndërtesa. Ai beson se është një mospërputhje e gjerë me kodet e ndërtesave dhe planifikimit të pamjaftueshëm, rreth projekteve të zhvillimit. Në pikëpamjen e tij, projektet pilote, duhet të ndërmeren në Zharrëz, për të demonstruar ndërtime të përshtatshme dhe standarde të zonimit, në mënyrë që sizmografët të instalohen në zonën e projektit dhe të përcaktojnë nëse thellësia e puseve të naftës, është një faktor kontribues i lëkundjeve.
- Një profesor i merituar që më parë shërbeu si Zëvendës Ministër i Energjisë dhe si Drejtor i Përgjithshëm i sektorit të naftës në Shqipëri, tha se ai beson që metodat intensive të nxjerrjes së naftës, të përdorura nga Bankers, është një mundësi e shkak i terrmeteve në zonën e Zharrëzës, sepse ka prova nga vende të tjera që duke përdorur metoda të ngjashme, mund të çojnë në terrmete. Prapëseprapë, thotë ai se duhet të ndërmerret një vlerësim i plotë, duke përfshirë këtu ekspertët e duhur, për të hartuar më mirë teknikat e nxjerrjes së naftës dhe që rreziqet të jenë ekzaminuar me kujdes. Ai thotë se duke njohur biografinë e çdo pusi naftë, do të ndihmonte përcaktimin, nëse Bankers duhet të përdorë metoda më të shëndetshme mjedisore.
- Përfaqësuesit e Institutit Sizmologjik Kombëtar Shqiptar, thanë se ata kanë ndërmarrë sondazhe monitorimi dhe gjeologjike për të kuptuar më mirë efektet e aktiviteteve të shpimit të Bankers dhe janë goxha familiarë me deklaratat e komunës së Zharrëzës, që kompania është për t'u fajësuar për terrmetet. Ata thonë se aktiviteti sizmik, është i zakonshëm në Shqipëri me lëkundje të rregullta të magnitudave të ulëta, gjatë gjithë vendit dhe periudhave me aktivitet sizmik të lartë, të atilla sikurse ato në vitin 2009 dhe 2012. Nga pikëpamja e tyre shqetësimet e komunitetit, duhet të merren seriozisht dhe në të njëjtën kohë, përpjekjet duhet të bëhen për përmirësimin e bashkëpunimit shkencor, në mënyrë që të verifikojnë çfarë po ndodhë gjeologjikisht. Ata, gjithashtu, thonë se më shumë duhet të bëhet për të komunikuar dhe arsimuar rreth kodeve të ndërtesave dhe aktivitetit sizmik në përgjithësi dhe palët e interesuara duhet të bien dakord me kushtet për një rishikim shkencor të të dhënave ekzistuese që rezultojnë në një konkluzion.
- Inxhinierët nga Instituti Kombëtar i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, të cilët ndërmoren vizita të vendit të projektit në vitin 2009, thanë se ata ndërmoren një rishikim të hollësishëm të shqetësimeve të fshatarëve dhe të të dhënave gjeologjike ekzistuese, një përpjekje kjo për të arritur një konkluzion të besueshëm. Nga perspektiva e tyre, deklaratat e komunitetit, nuk janë mbështetur nga të dhënat shkencore, sepse në vitin 2009, kishte një rritje të aktivitetit sizmik përmes Shqipërisë dhe plasaritjet e shtëpiave, kishin ngjarë përgjatë vijave, për shkak të këtij aktiviteti shtesë (dhe të magnitudës së lartë) gjeologjike. Inxhinierët

përshkruan disa hapa që ata besojnë se do të ndihmojnë të zgjidhin çështjen, përfshirë një ekip ekspertësh të paanshëm për të kompletuar një vlerësim dhe monitorim të detajuar bazuar në vend.

3.2.4 Konteksti / Informacion Shtesë

Gjatë udhëtimit vlerësues në Shqipëri, CAO mësoi që ankuesi me bazë në Tiranë, nuk ishte i informuar për disa deklarata të theksuara në ankesën e shkruar: si çështja e lidhjes së operacioneve të kompanisë me abortet në Zharrës dhe incidenti i të mbyturit në Marinëz. Arsyeja për këtë, sipas ankuesit, ishte se teksti i plotë i ankesës, ishte shkruar nga një koleg – shqiptar me bazë në Amerikë, i cili e dërgoi ankesën tek ambientalisti me bazë në Tiranë, duke i kërkuar atij ta dërgonte tek CAO. Ankuesi me bazë në Tiranë, tha se ai nuk e kishte lexuar në tërësi ankesën, përpara se ta dërgonte tek CAO.

Me të marrë atë ankesë, më 13 mars 2013, CAO kërkoi verifikim nga ankuesi me bazë në Tiranë, në mënyrë që ai t'i prezantojë banorët e Zharrëzës. Më 19 mars, ai e dërgoi tek CAO një letër shkruar nga inxhinieri me bazë në Zharrëz, firmosur nga 18 banorë të Zharrëzës, ku ata kërkonin ndihmën e ankuesit në kuptimin dhe shpjegimin e fenomenit të tërmeteve të shpeshta në Zharrëz. Sipas letrës, këta banorë, kërkuan ndihmën e ankuesit për shkak të ekspertizës së tij të dyfishtë, si gjeolog dhe ambientalist.

Ankuesi tha se ai nuk ishte në dijeni, në atë kohë, që korrespondenca fillestare që ai e dërgoi tek CAO, përbënte një ankesë zyrtare. Sipas perspektivës së tij, letra e firmosur nga banorët e Zharrëzës, përfaqësonte çështjen kryesore për të gjithë palët e interesuara, që janë shkaqet dhe efektet e tërmeteve afër vendit të projektit.

Sipas kompanisë dhe dokumentacionit të qeverisë, shqetësimet e komunitetit rreth aktivitetit të tërmetit, afër fushës së naftës, Patos-Marinëz, kanë qenë në vazhdim që të paktën nga mesi i vitit 2009, kur banorët filluan të ngrinin shqetësimet, rreth një lidhjeje midis aktiviteteve të nxjerrjes së naftës të Bankers, tërmeteve dhe dëmtimet e shtëpive. Në përgjigje të ankesave dhe të protestave të përsëritura, kryetari i AKBN, iu përkushtua një kërkimi shkencor, që të kuptojë dhe zgjidhë paqartësitë mbi shkaqet e lëkundjeve.

Një numër palësh të interesuara, që folën me CAO, thanë: AKBN më pastaj thirri një panel ekspertësh të hetojnë çështjen, i cili për arsye të ndryshme, më vonë, u shpërbë. Ankuesi me bazë në Tiranë, ishte në mesin e panelistëve. Sipas kompanisë, Bankers, ishte përjashtuar nga pjesëmarrja në panel edhe pse ajo ka siguruar të dhëna për panelistët pjesëmarrës për t'u rishqyrtuar.

Deri më sot, përpjekjet si për shembull, paneli i ekspertëve dhe i analizave të tjera, që janë ndërmarë nga palë të ndryshme, përfshirë ankuesit, kompaninë dhe shtetin – nuk kanë rezultuar në një konkluzion të pranuar gjerësisht rreth shkaqeve të tërmeteve.

4. Përmbledhje dhe Hapat e Mëtejshëm

4.1 Përmbledhje e Vlerësimit

Bazuar në intervistat e vlerësimit dhe në qartësimin nga ankuesi me bazë në Tiranë, çështja kryesore që do të adresohet nëpërmjet një procesi të CAO, është shkaku i tërmeteve, ngjitur me fushën e naftës në Patos-Marinëz.

Ankuesi, së bashku me shumë banorë të Zharrëzës dhe disa palë të interesuara të sektorit publik, besojnë se teknikat e nxjerrjes së naftës së kompanisë, janë për t'u fajësuar për tërmetet dhe përhapjen e gjerë të plasaritjeve të shtëpive dhe të ndërtesave në zonë. Kompania dhe disa përfaqësues të sektorëve të tjerë publik, besojnë se teknikat e kompanisë, nuk janë përgjegjës për tërmetet, prandaj të dhënat shkencore tregojnë që tërmetet ndodhin natyrishëm dhe që dy periudhat e protestave nga banorët e Zharrëzës dhe të tjerët, rastisën me periudhat e aktivitetit sizmik të lartë në tërë Shqipërinë. Megjithatë, palët e tjera të interesuara të sektorit publik, besojnë se nuk ka informacion të mjaftueshëm ose të dhëna që përcaktojnë shkaku të vërtetë të tërmeteve që ndodhin afër vendndodhjes Patos-Marinëz.

4.2 Interesat e Përbashkëta

Në intervista, takime, dhe bisedimet me secilën nga palët e interesuara kryesore, ekipi i CAO, dëgjoi interesat e përbashkëta dhe perspektivat si në vijim:

- Opinione të ndryshme mbi shkaqet e tërmeteve në Zharrëz dhe përreth, kanë çuar në marrëdhënie përçarëse dhe jo produktive midis qytetarëve, përfaqësuesve, drejtuesve të sektorit publik. Arritja e koncensusit në këtë çështje, është një prioritet për të gjitha grupet e palëve të interesuara.
- Ndërsa ekzistojnë shumë të dhëna shkencore dhe shtypi popullor, mbi shkaqet e tërmeteve, një monitorim më i detajuar dhe më specifik për vendndodhjen në Patos-Marinëz, do të rezultojë me informacion më bindës dhe të besuar. Kjo mund të arrihet, pjesërisht duke instaluar pajisje sizmike monitorimi në zonën e Patos-Marinëz.
- Një shqyrtim gjithëpërfshirës i informacionit ekzistues shkencor, së bashku me ndonjë informacion shtesë të nevojshëm, nga një grup teknik pune i besuar, ose ekip ekspertësh, mund të jetë një hap tjetër i arsyeshëm drejt zgjidhjes së çështjes.
- Përbërja e ndonjë grupi pune të mundshëm, duhet të vendoset bashkarisht me kompaninë, përfaqësues të përshtatshëm të sektorit publik, dhe ankuesit. Banorët e Zharrëzës, të cilët në përgjithsi janë ndier të marginalizuar dhe të paprezantuar në bisedimet rreth shkaqeve dhe efekteve të tërmeteve, duhet të diskutojnë dhe pranojnë në përfaqësim të përshtatshëm në lidhje me seleksionimin dhe pjesëmarrjen në ndonjë grup pune bashkëpunimi të mundshëm.

Përveç këtyre interesave të përbashkëta, është e rëndësishme të theksohet që kompania ka një projekt të financuar për ta instaluar në vend të sizmometërve në dy lokacione të fushës së naftës – një hap që ankuesit dhe palët e tjera të interesuara kanë pas rekomanduar për disa kohë. Kompania thotë se pajisja është porositur dhe aktualisht është duke u prodhuar.

Sizmometrat janë planifikuar që të instalohen nga Instituti Kombëtar Sizmik, në shtator të 2013. Sipas kompanisë, Instituti sizmologjik, do të jetë përgjegjës për monitorimin e të dhënave që vijnë nga sizmometrat dhe ato do të integrohen në programin për monitorim sizmik të vendit.

4.3 Hapat e Mëtejshëm

Nga interesat e forta të përbashkëta dhe marrëveshjes së gjerë, midis palëve të interesuara që një zgjidhje është e mundshme, nëpërmjet një hetimi më të mirë e më të besuar shkencor, palët e dinë që mund të jetë e vlefshme të bëjnë përpjekje për një zgjidhje të çështjeve nëpërmjet një procesi bashkëpunues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Një mënyrë e diskutuar, me secilin nga palët e interesuara kryesore, ishte ajo e një grupi pune bashkëpunues rreth shkencës dhe çështjeve teknike, i cili shpesh është referuar si “gjetja e fakteve bashkarisht”. Gjetja e fakteve bashkarisht, është një strategji që iu mundëson ekspertëve teknikë, vendimmarrësve dhe palëve të tjera të interesuara nga anët e kundërta të një çështjeje që të punojnë së bashku për të adresuar mosmarrëveshjet faktike.

Në rastin e tërmeteve, afër fushës së naftës Patos-Marinëz, një gjetje e fakteve bashkarisht ose proceseve të tjera bashkëpunuese, mund të ndihmojë që të përmirësojë mënyrën se si informacioni shkencor, është grumbulluar dhe paraqitur, hap linjat e komunikimit midis palëve të interesuara dhe – bazuar në rezultatet – ndihmon çdo grup të palëve të interesuara të vendos hapat e mëtejshëm të duhur dhe përgjigje afatgjata.

Bazuar në perspektivat e palëve mbi rezultatet e mundshme të një procesi bashkëpunues dhe, duke konsideruar pikat e përbashkëta të interesit, CAO do të vazhdojë të krijojë një ekip lehtësimi të besuar që të fillojë të punojë më palët në projektimin e një procesi të përqendruar në zgjidhjen e shkaqeve të tërmeteve në zonën e Zharrëz / Patos-Marinëz.

Midis çështjeve kritike për t'u adresuar në projektin fillestar të procesit, do të jenë: (1) përbërja e grupit bashkëpunues, (2) prezantimi i komunitetit dhe shpërndarja e informacionit dhe shkëmbimi midis banorëve dhe grupit bashkëpunues të punës dhe (3) identifikimi i qartë i çështjeve për t'u hetuar dhe diskutuar nga pjesëmarrësit në proces.

CAO, do të sigurohet që ekipi lehtësues, do të mbështetet tek parimet profesionale, duke udhëhequr proceset e përbashkëta të gjetjes së fakteve. Kjo përfshin sigurinë që palët do të punojnë së bashku, për t'u pajtuar në çështjet që kërkojnë analiza teknike, se kush do të shërbejë si ekspert teknik dhe si të lëvizet përpara, pas marrjes së analizave teknike.

###

Shtojca A: Trajtimi i procesit të ankesës së CAO

Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (CAO), është mekanizëm burimi i pavarur për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencinë e Investimeve të Garantuara Shumëpalëshe (MIGA) të Grupit të Bankës Botërore. CAO raporton direkt tek Presidenti i Grupit të Bankës Botërore dhe mandati i tij është të ndihmojë në adresimin e ankesave nga njerëzit e ndikuar nga projektet e mbështetura të IFC / MIGA, në një mënyrë që është e drejtë, objektive dhe konstruktive që të përmirësojë rezultatet shoqërore dhe mjedisore të këtyre projekteve.

Vlerësimi fillestar është ndërmarrë nga funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të CAO. Qëllimi i vlerësimit të CAO, është: (1) të sqarojë çështjet dhe shqetësimet e ngritura nga ankuesi(t), (2) të grumbullojë informacion se si palët e tjera të interesuara e shikojnë situatën, dhe (3) të ndihmojë palët e interesuara të kuptojnë opsionet e burimeve për ndihmë në dispozicion të tyre dhe të vendosë, nëse ata do të pëlqejnë të ndjekin një zgjidhje të përbashkët nëpërmjet funksionit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të CAO's, ose nëse çështja duhet të rishikohet nga funksioni i Përputhshmërisë së CAO.

Ky dokument është një dokument paraprak i pikëpamjeve të dëgjua nga ekipi i CAO, dhe shpjegimet e hapave të tjerë që varen nga fakti, nëse palët zgjedhin të ndërmarrin një proces të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes ose preferojnë procesin e Përputhshmërisë së CAO. *Ky raport nuk bën ndonjë gjykim mbi meritat e ankesës.*

Sipas Udhëzimeve Operative të CAO², hapat në vazhdim janë ndjekur në mënyrë tipike në përgjigje të ankesës që është marrë:

Hapi 1: **Pranimi** i marrjes së ankesës

Hapi 2: **Kriteret:** Përcaktimi i pranimit të kriterëve të ankesës për vlerësim nën mandatin e CAO (jo më shumë se 15 ditë pune).

Hapi 3: **Vlerësimi i CAO:** CAO ndërmerr një vlerësim të çështjeve dhe siguron mbështetje të palëve të interesuara në kuptimin dhe përcaktimin, nëse ata do të preferojnë të ndërmarrin një zgjidhje konsensuale nëpërmjet një procesi bashkëpunimi të thirrur nga funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes të CAO, ose nëse çështja duhet të trajtohet nga funksioni i Përputhshmërisë së CAO, të rishikojë dilijencën ligjore të shoqërisë dhe mjedisit të IFC/MIGA. Koha e vlerësimit mund të marrë kohë deri në 120 ditë pune, në maksimum.

Hapi 4: **Lehtësimi i zgjidhjes:** Nëse palët zgjedhin të ndërmarrin një proces bashkëpunues, funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes së CAO, fillon. Procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes, bazohet në mënyrë tipike ose fillohet nga një Memorandum Mirëkuptimi dhe / ose një rënie dakord reciprokisht mbi rregullat bazë midis palëve. Mund të përfshijë lehtësimin / ndërmjetësimin, gjetjen e fakteve bashkarisht, ose mënyra të tjera të miratuara që çojnë në një marrëveshje dhe qëllim të përshtatshëm. Qëllimi kryesor i këtyre lloj mënyrash, zgjidhjeje të problemeve, do të jenë të adresojnë çështjet e ngritura në ankesë, dhe ndonjë çështje tjetër të rëndësishme lidhur me

² Për më shumë detaje mbi rolin dhe punën e CAO, ju lutemi referohuni Udhëzimeve Operacionale të plota: http://www.cao-ombudsman.org/documents/CAOOperationalGuidelines_2013.pdf

ankesën që ishte identifikuar gjatë vlerësimit ose procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes, në një mënyrë që është e pranueshme nga palët e ndikuara³.

Ose

Vlerësimi i Përputhshmërisë / Hetimi: Nëse palët përcaktohen për procesin e Përputhshmërisë, funksioni i Përputhshmërisë i CAO, do të fillojë një vlerësim të dilijencës ligjore të mjedisit dhe shoqërisë së projektit, në çështje të vendos nëse një hetim përputhshmërie i performancës së IFC/MIGA, lidhur me projektin është i merituar. Koha e vlerësimit mund të merr deri në 45 ditë pune, në maksimum. Nëse, një hetim, është gjetur të jetë i merituar, Përputhshmëria e CAO, do të ndërmarrë një hetim të detajuar mbi performancën e IFC/MIGA. Një raport hetimi me ndonjë mospërputhje të identifikuar, do të bëhet publik së bashku me përgjigjen e IFC/MIGA.

Hapi 5: **Monitorimi** dhe ndjekja.

Hapi 6: **Përfundim** / Mbyllja e çështjes.

³ Kur palët e interesuara, nuk janë në gjendje të zgjidhin çështjen brenda një kohe të caktuar, Zgjidhja e Mosmarrëveshjes e CAO, fillimisht, do të kërkojë të ndihmojë palët e interesuara në tejkalimin e qorrsokakut. Nëse kjo nuk është e mundur, ekipi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes, do të informojë palët e interesuara, përfshirë stafin e IFC/MIGA, Presidentin e Grupit të Bankës Botërore, dhe publikun, që Zgjidhja e Mosmarrëveshjes e CAO, e ka mbyllur ankesën dhe e transferon atë tek Përputhshmëria e CAO për vlerësim.

Shtojca B: Intervistat e Vlerësimit të CAO

Vizita në vend, në Shqipëri, konsistonte në intervista dhe takime me ambientalistin me bazë në Tiranë, i cili paraqiti ankesën, një përfaqësues vendor i banorëve të Zharrëzës, dhe stafin e Bankers Petroleum, i cili përqëndrohet në shëndetin, sigurinë, çështjet sociale dhe ambientin. Ekipi i vlerësimit, gjithashtu, u takua me një varg palësh të tjera të interesuara, të cilët kanë një interes në çështjet përfshirë:

- Ministrin e Ekonomisë Shqiptare, Tregtisë dhe Energjisë;
- Kryetarin e Bashkisë së Zharrëzës;
- Kryetarin e Prefekturës së Rajonit Fier;
- Sekretarin e Përgjithsmëm të Prefekturës Fier;
- Katër individë familje / zotët e shtëpive në Zharrëz, të cilët janë të shqetësuar, sepse plasaritjet dhe dëmtimet e shtëpive të tyre, mund të jenë si rezultat i teknikave të nxjerrjes së naftës së Banker Petroleum;
- Banorë të tjerë të Zharrëzës, me shqetësime të njëjta, të cilët u ftuan të marrin pjesë në takimet me komunitetin, ku ekipi i CAO, u prezantua;
- Drejtori i Agjencisë së Burimeve Natyrore Shqiptare (AKBN);
- Kryetarin e Efikasitetit të Energjisë për AKBN, i cili në të kaluarën ndërmori hetimin sizmik për AKBN;
- Një profesor të merituar, autor dhe ish-Drejtorin e Përgjithshëm të Sektorit të Naftës në Shqipëri, i cili, gjithashtu, shërbeu më parë, si Zëvendës Ministër i Energjisë;
- Përfaqësues të Institutit Shqiptar të Gjeoshkencës; dhe
- Përfaqësues të Institutit Sizmik të Shqipërisë.